

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Leya” sh.p.k

KREU I

Themelimi, emri, objekti kohëzgjatja, selia

Neni 1

Sot më datë 11.02.2021 shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Leya” sh.p.k, në përputhje me ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”si dhe ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” harton statutin e saj te ri te kësaj shoqërie sipas ligjit sa sipër me Ortakun e Vetëm Z.Nino Imeraj me kartë identiteti Nr J10404079C, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është në rrugën Petro Nini Luarasi, Tiranë. Kjo shoqëri gëzon të drejtën për të hapur filiale, degë apo agjenci të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3

Shoqëria “Leya” sh.p.k, do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhe kohe mbi 10 vjet. Shoqëria mund të zgjasë afatin e veprimtarisë së saj ose mund të mbyllë aktivitetin e saj edhe pas mbarimit të këtij afati e realizuar kjo sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut, me vendimin e Ortakut të Vetëm dhe sipas kritereve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Shoqëria “Leya” sh.p.k, për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie nuk përgjigjet për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tij të cilat nuk janë përfshirë në kapitalin e kësaj shoqërie.

Neni 5

Administrator i shoqërisë është Z. Nino Imeraj , i datëlindjes 04.04.1991, lindur në Tirane dhe banues në Tirane, me kartë identiteti Nr J10404079C Administratori i shoqërisë do të qëndrojë në këtë detyrë për 2 vjet me të drejtë riemërimi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Neni 6

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë është : Aktivitet ne fushen e marketingut. Prodhim dhe studim i sherbimeve te marketingut per tregun vendas dhe te huaj. Marketing te

sherbimeve pa kufizime territoriale, te sherbimeve te komunikimit qe rrjedhin nga zhvillimi i teknologjise.

Ofrimin e sherbimeve te ndryshme online dhe aktivitet kerkimor. Aktivitete profesionale dhe trajtime me sisteme ne largesi dhe multimediale.

Aktivitet ne fushen e organizimit te seminareve, konferenca, organizime te pergjithshme dhe aktiviteteve te promovimit te imazhit.

Aktivitet ne fushen e tregtise elektronike edhe per llogari te paleve te treta.

Shoqeria mund te marre pjese ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njejte ose te ndryshem.

Objekti i shoqërisë mund te ndryshohet, mund te zgjerohet ose kufizohet me Vendim te Ortakut te Vetëm ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) leke i ndarë ne 1 pjese me vlerë nominale 10.000 lekë, që i përket Ortakut te Vetëm të kësaj shoqërie.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë përkundrejt personave të tretë.

Kapitali themeltar mund të shtohet ose ndryshohet vetëm me Vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 8

Kapitali themeltar është i ndarë ne 1 pjesë, e barabartë me 10.000 (dhjetë mijë) leke. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit vendoset me Vendim të Ortakut të Vetëm .

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 9

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Vendimi i Ortakut të Vetëm

Ortaku i Vetëm vendos për :

- a) Bilancin Vjetor
- b) Ndryshimet ne Statut
- c) Shtimin dhe pakësimin e Kapitalit themeltar
- d) Emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë
- e) Menaxhimin e llogarive bankare te shoqërisë.
- f) Emërimin e Ekspertit kontabël
- g) Hapjen e degëve, filialeve apo përfaqësitë e saj.
- h) Shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër të saj.
- i) Zgjatja e afatit të aktivitetit të saj.
- j) Vendime për marrje pjesë në shoqëri të tjera.
- k) Arovimin e rregullores së shoqërisë
- l) Kalimin e shoqërisë në likuidim si dhe të mbylljes së Bilancit jashtë Likuidimit.

Neni 10

Shoqëria merr në ngarkim të drejta dhe detyrime kontraktuese e jashtëkontraktuese brenda kufijve të Kapitalit të saj themeltar.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 11

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet Kontratës së Punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

SEKRETI I PUNËS

Neni 12

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga kjo shoqëri.

Neni 13

Shoqëria Tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një ekspert kontabël të autorizuar i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojnë nga moskryerja e detyrës së tij. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, në rast se vërehen gabime në punën e tij gjë që e bën të pamundur kryerjen e detyrës.

MARRËDHËNIET EKONOMIKE - FINANCIARE

Neni 14

Periudha financiare vjetore fillon me datë 01 Janar dhe mbaron në datën 31 dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, raportet dhe operacionet e vitit financiar si dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen me vendim të Ortakut të Vetëm. Miratimi i Pasqyrave Financiare mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda muajit maj të çdo viti pasardhës.

Neni 15

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të rezultatit të shoqërisë me Fitim, Ortaku i Vetëm përcakton pjesën e fitimit që do të kalojë për fondin rezervë, për investime apo do të ndahet si dividend.

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

Neni 16

Me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratën e themelimit, zgjatja e tij bëhet vetëm me Vendim të Ortakut të Vetëm.

Shpërbërja e Shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe në çfarëdo shkaku. Në rast mbyllje, Ortaku i Vetëm vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke i përcaktuar dhe detyrat konkrete. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi “Shoqëri në likuidim e sipër”. Mbas njoftimit të mbylljes së likuidimit të shoqërisë do të kryhen formalitetet e duhura që shoqëria të ç’regjistrohet nga Regjistri Tregtar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 17

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut i referohet Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Statuti përpilohet në katër kopje për t’ju shpërndare organeve kompetente për regjistrimin e saj si person juridik dhe si subjekt privat.

Neni 18

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar:

Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Ligji 9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Ligji 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

SHOQËRIA ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“Leya” sh.p.k

ORTAKU I VETEM

Z.Nino Imeraj

